



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 19.06.25 Nr.: 01-1481

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	<u>26825/25</u>
Nr. i fq. / Br. st	<u>-3-</u>
Data: / Datum	<u>17.06.25</u>
VUSHTRRI - VUÇITRN	

02 Nr. 695-1/25
17.06.2025



KOMUNA VUSHTRRI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për Krijimin e Task Forcës

Ndërmjet:

I. Komunës së Vushtrrisë, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi, (në tekstin e mëtejme Komuna),

dhe,

II. Kompania Rajonale e Ujit “Mitrovica”, Rr. Liqenit – Suhodoll, pa. Nr në Mitrovicë, përfaqësuar nga z. Bashkim Kurti, Kryeshef Ekzekutiv, (në tekstin e mëtejme KRU “Mitrovica”). Palët me këtë nënshkruajnë këtë marrëveshje për bashkëpunim, si në vijim:

Neni 1 – Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një Task Force të përbashkët ndërmjet KRU Mitrovica dhe Komunës së Vushtrrisë për të parandaluar dhe ndaluar keqpërdorimin e ujit të pijshëm gjatë sezonit veror, duke garantuar furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm për qytetarët, Uji i pijes mund të përdoret vetëm për **pije dhe higjienë personale**, si: larje, pastrim enësh dhe nevoja bazike të jetesës, Uji i pijes është burim jetik dhe përdorimi i tij është i lejuar vetëm për **konsum njerëzor dhe higjienë personale**,

Neni 2 – Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në:

- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- Udhëzimet administrative për menaxhimin e resurseve ujore dhe mbrojtjen e ujit të pijshëm;
- Kompetencat e ndërmarrjes publike për menaxhimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Neni 3 – Objektivat e Task Forcës

Task Forca do të ketë këto objektiva:

1. Monitorimi i përdorimit të ujit të pijshëm në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
2. Identifikimi i rasteve të keqpërdorimit të ujit.
3. Njoftimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për përdorim racional të ujit.
4. Marrja e masave konkrete kundër shkelësve.
5. Hartimi i një plani veprimi dhe raportimi i rregullt për rezultatet.

Neni 4– Përbërja dhe funksionimi i Task Forcës

1. Task Forca do të përbëhet nga përfaqësues të KRU Mitrovica dhe të Komunës së Vushtrrisë.
2. Anëtarët do të caktohen me vendim nga secila palë, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes.
3. Task Forca do të ketë një koordinator, i cili do të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët.
4. Mbledhjet e Task Forcës do të mbahen një herë në javë ose më shpesh, sipas nevojës.

Neni 5 – Obligimet e Palëve

KRU Mitrovica obligohet të:

- Sigurojë të dhëna për shpenzimet e ujit dhe vendet me konsum të dyshimtë.
- Ofron mbështetje teknike dhe logjistike për monitorim në terren.
- Bashkëpunon në fushatat informuese për qytetarët.

Komuna e Vushtrrisë obligohet të:

- Sigurojë përkrahje për zbatimin e masave administrative dhe ligjore kundër keqpërdoruesve.
- Angazhojë inspektorët komunalë për mbikëqyrje dhe ndërhyrje të shpejtë.
- Ndihmojë në realizimin e fushatave ndërgjegjëse në media dhe terren.

Neni 6 – Afati i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet e vlefshme deri më 30 shtator 2025. Afati mund të zgjatet me marrëveshje të përbashkët.

Neni 7 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo marrëveshje do të zgjidhet me dialog dhe mirëkuptim ndërmjet palëve. Nëse nuk arrihet marrëveshje, palët do të ndjekin procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 9 – Masat ndëshkuese dhe zbatimi i ligjit

- Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, veçanërisht nenet 53, 74, përdorimi i ujit të pijshëm për qëllime të ndaluara, si: ujitja e sipërfaqeve, larja e automjeteve, pastrimi i rrugëve apo trotuareve, konsiderohet keqpërdorim i resurseve ujore dhe kundërvajtje ligjore.
- Task Forca, në bashkëpunim me Inspektoratin Komunal dhe KRU Mitrovica, do të ndërmarrin masa në suaza të kompetencave të tyre të parapara me legjislacionin në fuqi.

Neni 10 - Kompetenca për shqiptimin e gjobave:

- Gjobat administrative shqiptohen nga **Inspektorati Komunal i Komunës së Vushtrrisë**, në përputhje me **Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës**,;
- **KRU Mitrovica**, do të ndërmarrë **masa teknike** si: ndërprerja e përkohshme e furnizimit me ujë.
- Zbatimi i masave ndëshkuese bëhet nga autoritetet kompetente në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11 - Dispozitat përfundimtare

- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët
- Marrëveshja është përgatitur në tri (3) kopje origjinale, nga një për secilën palë dhe një për ARRU.

Komuna e Vushtrrisë

Ferit Idriz, Kryetar



Kompania Rajonale e Ujit
"Mitrovica" Sh.A.

Bashkim Kurti, Kryeshef Ekzekutiv



Vushtrri, më _____ 2025